



## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

---

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare" Rr. 158/10, 123/12, 43/14 dhe 153/15) dhe në lidhje me nenin 16 dhe 22 të Rregullores për planifikim Rr. nr. 02-15/VIII-2/2013 nga 1 gusht i vitit 2013, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

### **PROGRAMIN I PUNËS SË BANKËS POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2016**

1. Programi i punës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm: Programi i punës) përgatitet në bazë të Udhëzimeve për punë të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016, UP nr. 02-15 / VIII-1/2015 nga 25 qershor i vitit 2015 dhe aktiviteteve të planifikuara nga njësitë organizative për vitin 2016.

2. Fokusi kryesor i aktiviteteve në Programin e punës edhe këtë vit është vendosur në qëllimet kryesore strategjike të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore), të përcaktuara nga Plani strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën kohore të viteve 2016 deri 2018, PS nr. 02-15 / V-1/2015 nga 7 maji i vitit 2015.

3. Programi i punës paraqet përpunim të hollësishëm të qëllimeve të përcaktuara dhe udhëzimeve për periudhën e ardhshme, nga aspekti i bartësve, afateve dhe statusit të realizimit të tyre në përputhje me shtojcën nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij Programi të punës, duke përfshirë edhe pasojat financiare nga realizimi i tyre, të paraqitura në rishikimin e bilancit të projektuar të gjendjes aktuale dhe për tre vitet e ardhshme, në përputhje me shtojcën nr. 2 e cila është pjesë përbërëse e këtij Programi të punës.

4. Programi i punës përfshin aktivitetet që lidhen me realizimin e objektivave kryesore të Bankës Popullore, para së gjithash në fushën e politikës monetare, tregjet financiare, menaxhimin me rezervat valutore, stabiliteti financiar, lëshimi dhe menaxhimi i kartëmonedhave dhe monedhave, sistemet pagesore, mbikëqyrje dhe statistika, si dhe shumë aktivitete që paraqesin mbështetje të funksioneve kryesore të Bankës Popullore, në lidhje me veprimtarinë kërkimore, teknologjinë e informacioneve, auditimit të brendshëm dhe menaxhimin korporativ.

Ndarja e aktiviteteve programore në bazë të qëllimeve të përcaktuara strategjike dhe bartësve, është kryer në mënyrën si vijon:

I. Ruajtja e stabilitetit të çmimeve nëpërmjet kursit stabil të denarit në raport me euron

- 17 aktivitete, bartës: PMK, TF

II. Ruajtja e një sistemi bankar stabile dhe të, si parakusht kryesor për stabilitetin financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike në vend.

- 27 aktivitete, bartës: MJL, MT, FB, udhëheqësia

III. Menaxhimi efikas me rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë gjatë ekuilibrit optimal të principeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthesës (rezultatit) nga menaxhimi.

- 8 aktivitete, bartës: TF

IV. Mbështetje për zhvillim të tregjeve financiare në vend

- 2 aktivitete, bartës: TF

V. Rritja i efikasitetit të sistemit për furnizim dhe përpunim të kartëmonedhave dhe monedhave dhe rritja e kualitetit dhe funksionalitetit të parave të gatshme më qarkullim.

- 13 aktivitete, bartës: TR

VI. Ruajtja e nivelit më të lartë të sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit në sistemet pagesore në vend dhe sigurimi i kushteve për lidhje ndërkufitare të sistemeve pagesore.

- 16 aktivitete, bartës: SP

VII. Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore në fushat të cilat janë të një rëndësie të madhe për realizimin efikas të qëllimeve të Bankës Popullore.

- 17 aktivitete, bartës: PMK, FB

VIII. Sigurimi i të dhënave statistikore kualitative, tërësisht në pajtueshmëri me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane, duke mbajtur llogari për barrën e raportimit dhe përhapjen e tyre efikase, desiminim në kohë dhe të thjesht deri te shfrytëzuesit.

- 21 aktivitete, bartës: ST, SP

IX. Përgatitje e Bankës Popullore për bashkim dhe anëtarësim në sistemin evropian të bankave qendrore.

- 5 aktivitete, bartës: KG, SP

X. Ndjekja e trendëve në veprimtarinë e bankave qendrore, forcimi i fleksibilitetit në raport me ndryshimet që imponohen nga mjedisi, menaxhim efektiv me rreziqet në të gjitha segmentet e punës, përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë sociale të institucionit.


- 64 aktivitete, bartës: udhëheqësia, IT, KG, Muzeu, PJ, BNJ, FKK, ATR, Biblioteka dhe arkivi, AB

5. Programi i punës përfshin edhe aktivitete që kanë për qëllim harmonizimin e nevojave ligjore, organizative dhe për burime të Bankës Popullore në procesin e anëtarësimit në Bankën Qendrore Evropiane dhe të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, e cila është në përputhje me rekomandimet e përfshira në raportin "Analiza e nevojave të Bankës Popullore", e miratuar nga Komiteti drejtues i IPA projektit.

6. Gjatë vitit 2016, njësitë organizative në Bankën Popullore planifikojnë të realizojnë 190 aktivitete, prej të cilave 77 janë të rregullta, ndërsa 113 janë aktivitete të reja.

7. Dinamika e realizimit të Programit të punës është e shpërndarë në mënyrë të barabartë, gjatë së cilës duke pasur parasysh përgatitjet e nevojshme, shumica e aktiviteteve të reja do të përfundojnë deri në fund të vitit 2016, ndërsa aktivitetet e rregullta do të realizohen gjatë gjithë vitit.

**Dinamika e aktiviteteve të planifikuara në Programin e punës për vitin 2016**



8. Në vitin 2016 shënohet 70 vjetori i veprimtarisë së bankës qendrore në Republikën e Maqedonisë. Shënimi i këtij jubileu të rëndësishëm do të zhvillohet gjatë vitit, nëpërmjet një sërë organizimesh nga Banka Popullore.

9. Programi i punës hyn në fuqi në datën e miratimit.

**Nr. 02-15/XVI-1/2015**  
**17 dhjetor 2015**  
**Shkup**

**Guvernator**  
**dhe Kryetar i Këshillit të bankës**  
**Popullore të Republikës së Maqedonisë**  
**Dimitar Bogov**